

Fjala e Paqes



*Kini kujdes veten
që zemrat tuaja
të mos kalamenden
prej grykësisë, prej shfrenisë ...
që ajo Ditë
të mos vijë papritmas.
(Lk 21,34)*

Lajmëtar fetaro-kulturor i Arqipeshkvisë Metropolitane Shkodër - Pult **Nr. 6 (125) Viti XVII Tetor - Nëntor 2015**

4 NËNTOR 2015 25-VJETORI I TË PARËS MESHË TË SHENJTË PAS VITIT 1967



Kemi kënaqësinë t'u paraqesim lexuesve të këtij numri të gazetës "Fjala e Paqes" kushtuar tërësisht eventit që u kremtua me 4 nëntor të vitit të kaluar që u parapri nga një numër i madh aktivitetesh kulturore të cilat gjetën mbështetje dhe jehonë të gjerë në mediat lokale dhe kombëtare. Fakti që përkujtohet një event i para 25 viteve, është një arsye e fortë për të kremtuar. Kur themi "për të kremtuar" kemi parasysh ripërjetimin e atij eventit për të kuptuar më mirë thelbin e tij dhe për ta bërë aktual në ditët tona. Komunitetit tonë, në shkallë vendore dhe kombëtare, iu dha mundësia për të falenderuar Zotin që na fali lirinë e mohuar të praktikimit të besimit pas një periudhe të gjatë vuajtjeje nën dikaturën komuniste.

Vuajtje kjo që mori trajtë nga gjaku i martirëve. Pikërisht për këtë arsye, zgjodhëm që ata të ishin edhe protagonistët e këtij eventit. Ky numër i gazetës është edhe një mundësi për të falenderuar të gjithë ata që në një mënyrë apo një tjetër, kontribuan në mbarëvajtjen e kremtimeve: organizatorët, bashkëpunëtorë, gazetarë, njerëz të artit dhe kulturës, besimtarë dhe institucione që kontribuan qoftë me praninë, qoftë me ndërhyrje konkrete siç ishte restaurimi i Kapelës në Varrezat Katolike të Rrmajit. Ju urojmë që t'i ruani përherë të gjalla këto kujtime, sepse nga e shkuara varet e tashmja jonë, dhe mbi këtë të tashme ndërtohet e ardhmja e secilit. Edhe njëherë, URIME!

Redaksia



PAPA FRANÇESKU NË AFRIKË

Ati i Shenjtë Papa Françesku bëri Udhëtim Apostolik në këto Shtete të Afrikës: Kenya, Uganda dhe Republika Afrikës Qendrore në datë 25-30 nëntor 2015, duke bërë thirrje për paqe, vëllazërim dhe kundër çdo llojë dhune kundër njeriut, në emër të Zotit.

Për herë të parë në historinë e Dera të Shenjtë u hap jashtë Vatikanit, në katedrale, në Bangui (Republika e Afrikës Qendrore), edhe pse hapja zyrtare mbetet ajo që kremtohet në Shën Pjetër në Romë, më 8 dhjetor 2015.

KALENDARI I AKTIVITETEVE NË 25-VJETORIN E MESHËS SË PARË

4 Tetor 2015

*Dita e dhurimit të gjakut.
Prezantimi i logos së 25-vjetorit të meshës së parë
dhe i kalendarit të aktiviteteve.*

Logoja e 25 vjetorit të Meshës së Parë

Në qendër të logos është një pemë e përbërë nga rrenjë, trugu e kurora me gjethe. Pema e jetës. Pema ka formën e një çinari që ndodhet në vendin ku u pushktuan një numër i madh martirësh të njohur e të panjohur. Sikur të kishte gojë çfarë nuk do të fliste për turturat e qëndresën deri në klithjen «Rroft Krishti Mbret». Një pemë që na kujton edhe lashtësinë e këtyre trojeve, të ungjillizuara nga apostujt të cilët mbollën së pari besimin në një popull që më përpara ishte pagan. E kaluara e historia janë vetëdija e një populli që kërkon

të orientohet drejt të ardhmes, prandaj kjo logo kërkon të na kujtojë rrenjë tona e jo vetëm kaq, por edhe Shpresën (Zotin) që na ka mbështjellë gjatë gjithë historisë sonë. Logoja është historia në miniaturë e vendit tonë, që na nxit të frymëzohemi e të marrim mesazhin e jetës, shpresës e të qëndresës. Liria është sfidë e përditshme, që kërkon dhurim të përditshëm e kjo na kujton drurin e jetës, Kryqin.

Duam të falenderojmë të gjithë personat, të cilët kanë kontribuar me ide, por falenderimi kryesor dhe më i veçantë shkon për dizenjatorin Eugjen Makaj. Faleminderit Eugjenjo!



17 Tetor 2015

Famullia e shën Shtjefnit me rastin e 25 vjetorit të meshës së parë dhe në prag të festës së Zojës së Shkodrës, ka prezantuar librin e Dom Ndoc Nikajt (Historia e Shqypnis') në sallën Mikel Koliqi në orën 11.00.

Dom Ndoc Nikaj është ndër promotorët më të medhenj të lirisë. Përjetoi sisteme të ndryshme që fatkeqësisht të gjithë e persektuan, por ai nuk rreshti së shkruari në gjuhën shqipe, duke nxitur popullin të rrëzonte tiranët. Historinë e Shqipërisë e shkroi atëherë kur të shkruarit shqip ishte i ndaluar, duke na dhuruar një vepër me vlera të ralla historike e letrare.

Ky autorë edhe pse ka një rëndësi shumë të madhe në historinë e pavarsisë e lirisë nuk ka marrë vendin e duhur. Ky 25 vjetor i Meshës së Parë është edhe një ringjallje e veprës së tij e gjithashtu e ëndrrës së tij për liri, besim e kulturë.



3 Nëntor 2015

Procesioni me stendat e martirëve, nga Motrat Klarise, ish burgu, tek varrezat e Rrmajt në orën 15.00.

E gjithë dioqeza së bashku me stendat e martirëve në duar, në procesjon, bënë rrugën që përshkuan martirët drejt pushkatimit. Rruga e kujtesës u ndriçua me lutje e falenderime për fenë e tyre.

31 Tetor 2015

“Mbrëmje artistike”, Salla “Kardinal Mikel Koliqi” në orën 17.00. Një mbrëmje me poezi e këngë frymëzuar nga liria.

Në këtë mbrëmje të gërshetimit poetik e muzikor, fjala tingulloi si himn i lirisë së munguar, e tingulli si fjalë e gjuhës së dhimbjes.



4 Nëntor 2015

Mesha tek varrezat e Rrmajt në orën 10.00
dhe inaugurimi i Kapeles se Varrezave,
e restauruar nga Ministria e Kulturës.

PËRSHËNDETJA E ARQIPESHKVIT
IMZOT ANGELO MASSAFRA



Hirësi Shumë e Nderuar, Kardinal Salvatore De Giorgi, që e doni Shqipërinë dhe keni dashur të jeni i pranishëm këtu sot: për ardhjen tuaj në Shkodër dhe sepse na keni sjellë bekimin e Papa Françeskut ju falënderojmë me gjithë zemër; Shkëlqësia e Juaj, Nunci Apostolik dhe ju Bashkëvëllezër në Episkopatin e kësaj toke, i cili qe rithemeluar nga kujdesi atëror i shën Gjon Palit II në përfundim të ngjarjeve të trishtuara të diktaturës komuniste; Meshtarë dhe të kushtuar Zotit, bij të këtij populli dhe ju misionarë dhe misionare, Autoritete Fetare që na nderoni me praninë tuaj me shpirt bashkëndarjeje të gëzimit tonë; Zotëri Kryeministër, Zonja Kryetare e Bashkisë së Shkodrës, Zonja Ministre e Kulturës dhe të gjitha ju Autoritete që na keni ndihmuar ta bëjmë solemne këtë ditë nëpërmjet ndërhyrjeve domethënëse siç janë restaurimi i rrethimit dhe i Kapelës që pas pak minutash do ta bekojmë dhe për të cilat ju falënderojmë që tani; Vëllezër e Motra, shumë prej të cilëve keni qenë të pranishëm në Meshët e Shenjta të 4 dhe 11 nëntorit 1990:

“Qoftë bekuar Zoti që s'na dha kafshatë për dhëmbët e tyre. Shpirti ynë shpëtoi si trumcaku prej grackes së gjuetarëve: laku u këput e ne shpëtuam! Ndihma jonë është në Emër të Zotit, që krijoi qiellin e tokën”. (Ps 124)

Dëshiroj t’ju drejtoj përshëndetjen time më të singërtë me fjalët e Psalmi 124 që, mendoj, e shprehin shumë mirë kuptimin e pranisë sonë këtu sot. Në të vërtetë, po kremtojmë ringjalljen e këtij populli që ndodhi 25 vjet më parë, pas një periudhe të gjatë në të cilën të gjitha liritë dhe, sidomos, liria e shprehjes së fesë ishin ndaluar dhe, në këtë menyrë, ishte shkelur dinjiteti i popullit shqiptar. Një dinjitet që, megjithatë, nuk ka humbur kurrë! Fe e Atdhe kanë qenë për popullin tonë dhe për Martirët e tij një binom i pandashëm; aq sa kur është përpjekur të nënvizohet dhunshëm vetëm në Atdheun, duke keqpërdorur emrin e “popullit”, ka ndodhur ajo që dihet tashmë nga të gjithë dhe efektet e së cilës i shohim edhe sot, 25 vite më vonë.

Ati i Shenjtë Françesku i ka treguar gjithë botës Shqipërinë si shembull të dialogut ndërfetar të hapur ndaj bashkëjetesës së qetë; dhe është e vërtetë! Por a do të ishim me të vërtetë të aftë për këto virtyte nëse ne ne do të mungonte koncepti “i vërtetë” i “shqiptarisë”?

Pikërisht ky perceptim na bën të jemi të aftë të kapërcejmë konfliktet; me anën e tij u kemi bërë ballë stuhive të historisë; me anë të tij sot mund ta quajmë veten një popull që ecën drejt një të ardhmeje plot me shpresë. Por çfarë është “shqiptaria” nëse jo ky gërshetim i mrekullueshëm mes Fesë në një Hyj të vetëm dhe përkatësisë në një Atdhe të kushtuar Atij?

Po, 25 vjet më parë, po në këtë datë, më 4 nëntor 1990, u kremtua riti i parë publik liturgjik pas shkurtit të vitit 1967, kur u ndaluan fetë. Guximi i Dom Simon Jubanit, past dritë, me disa meshtarë dhe guximi i disa besimtarëve kanë bërë që feja të fillojë të shfaqet përsëri haptazs, duke hedhur themelet për ngjarjen e madhe të fesë së 11 nëntorit të po atij viti, kur prania e popullit në këto varreza u bë e papërmbajtshme, por edhe për 16 nëntorin, kur vëllezërit myslimanë e morën përsëri Xhaminë e Plumbit, simbol të fesë së tyre po ashtu të ndaluar nga totalitarizmi komunist ateist.

Si atë ditë, në menyrë të dukshme rishfaqej feja, e po bashkë me të rilindi edhe Atdheu, i zhveshur deri në atë moment prej karakteristikës së vet kryesore, asaj të përkatësisë në Hyjin, për t’iu nënshtruar “hyjnive” të tjera, atyre të komunizmit personal të improvizuar herë sipas sistemit ateist ballkanik, rus e në fund kinez.

Kështu pra, sot po kremtojmë guximin e këtij populli për ta ripërvetësuar identitetin dhe dinjitetin e vet, por më lejoni të shpreh edhe një bindje timen personale: sot, sidomos, kremtojmë vullnetin suprem të Hyjit për të rimarrë atë që është e tija, këtë popull pasi edhe ky i përket.

Njëmend Zoti ia pat fshehur fytyrën e vet për pak kohë popullit tonë, por pastaj ka dashur edhe një herë të na dëftohet në mëshirën e vet si Hyj-Paqeje.

Prandaj me të drejtë, me fjalët e Psalmi mund të përsërisim ende edhe sot:

“Qoftë bekuar Zoti që s'na dha kafshatë për dhëmbët e tyre. Shpirti ynë shpëtoi si trumcaku prej grackes së gjuetarëve: laku u këput e ne shpëtuam! Ndihma jonë është në Emër të Zotit, që krijoi qiellin e tokën”.

Atij i qoftë nderi, lavdia dhe falënderimi, sot e në amshim. Amen.

VITI JUBILAR I MËSHIRËS

Hapja e Vitit të Shenjtë të Mëshirës do të jetë në Romë
më 8 dhjetor, në të kremten e Zojës së Papërlyer, ndërsa
për Dioqezën tonë është caktuar për të dielën,
më 13 dhjetor, në orën 15.00.



HOMELIA E KARDINALIT SALVATORE DE GIORGI, ARQIPESHKËV EMERITO I PALERMOS

Në dritën e Fjalës së Hyjit që dëgjuam, po rijetojmë në këtë varrezë një prej ngjarjeve më tragjike të historisë së vonë të Kishës suaj, e shtypur prej përndjekjes komuniste, por që sot gëzon për restaurimin dhe bekimin e kishëzës, dëshmitare e dhunave të egra të përndjekësve dhe e fesë heroike të etërve tuaj.

Kjo varrezë ishte profanuar prej mizorisë çnjerëzore të të patenzonëve me vrasjen e meshtarëve dhe laikëve në mars të vitit 1946 të pushkatuar jashtë murit.

Nga viti 1967 është ndaluar çdo shprehje publike e fesë prandaj nuk u kremtua më asnjë Meshë publike. Por më 4 nëntor 1990 u kremtua Mesha e Parë, shprehje e guximit baritor të meshtarit Dom Simon Jubani dhe e nismës së atyre besimtarëve që e kishin thirrur për atë qëllim.

Me emocion dhe me gëzim në këtë kremtim eukaristik, 25 vjet më vonë, po kremtojmë dhe po rijetojmë atë Meshë të parë si shenjë e ringjalljes dhe e shpresës, e shprehur në mënyrë të shkëlqyeshme prej logos së zgjedhur për këto kremtime jubilarë: pema e jetës, çinari i varrezës, afër të cilit janë pushkatuar një numër i madh martirësh të njohur dhe të panjohur me thirrjen “Rroftë Krishti Mbret”. Ai kujton rrënjët tuaja të hershme të krishtera të mbjellura prej Apostujve mbi brazdën e paganizmit, kujton të kaluarën e vuajtjeve tuaja të jetuara duke shpresuar në Zotin e vuajtur e të lartësuar, tregon të tashmen e lirisë së rigjetur, e destinuar të rritet në fenë dhe në shpresën që nuk zhgënjën. Kjo shpresë ka një emër: Krishti i vdekur dhe i ringjallur, në shenjë të Kryqit të lavdishëm, me të cilin e ka mposhtur botën.

Po e rijetojmë atë ngjarje me ndjenjat e fesë, të emocionit dhe të gëzimit të popullit hebre të kthyer në atdhe pas mërgimit në Babiloni, që e endoqem në leximin e parë.

Është gëzimi i njësisë së rigjetur në fenë e Hyjit të etërve që i ka liruar, dhe në zbatimin e Ligjit të tij, e vetmja dritë për rindërtimin që dukej i vështirë, nëse jo i pamundur.

Prifti Esdra u urdhëron priftërinjtë ta lexojnë dhe ta komentojnë me pjesë gjatë gjithë mëngjesit, mes vëmendjes së devotshme e të prekur të popullit: një gëzim i madh që shpërthen në nxitjen drithëruese të Esdrës dhe të qeveritarit Nehemia: “Kjo është dita që i kushtohet Zotit, Hyjit tonë! Mos u trishtoni, sepse gëzimi i Zotit është fuqia juaj”.

Është ajo që na përsërit Zoti ne çdo të diel, ditën e kushtuar atij, në të

cilën na fton dhe na pret si bij në Shtëpinë e vet për të na dhuruar gëzimin e vet me dritën e Fjalës së vet dhe me forcën e Bukës Eukaristike, të Trupit e të Gjakut të Birit të vet.

Të mos e lëmë pa përgjigje ftesën e tij: kështu do ta privonim veten prej dhuratës së madhe të dashurisë së tij duke dizertuar Meshën e së Dielës.

Përgjigjja jonë le të jetë e hareshme, e gëzueshme, e vetvetishme, si

ajo e izraelitëve kur u kthyen prej mërgimit në këngën që dëgjuam dhe përsëritëm në psalmin përgjegjës: “Seç u gëzova kur më thanë eja të shkojmë në shtëpinë e Zotit... për të lëvdur emrin e Zotit”, burim i paqes, i njësisë, i sigurisë dhe i çdo të mire.

Të marrim pjesë në Meshën e së dielës nuk është thjesht detyrë, është një nevojë pa të cilën nuk mund të bëjmë nëse duam të jetojmë si të krishterë.

Në përndjekjet e para të Kishës, si edhe në tuajën, ka pasur prej atyre që kanë parapëlqyer martirizimin për të mos munguar në takimin e së dielës me Zotin: Mesha kremtohej fshehurazi dhe në burg madje me pak bukë e verë. Çfarë mrekullie! Edhe sot në shumë anë të botës ka të krishterë që marrin pjesë në Meshë megjithëse e dinë se rrezikojnë jetën për arsye të atentateve të paparashikueshme në kishat e tyre. Sa dëshmi e bukur feje! Dhe është domethënës fakti se në këto ditë po zhvillohet në Tiranë një Kuvend për të krishterë të përndjekur, që ne i kujtojmë në mënyrë të veçantë në këtë Meshë,

duke mos e harruar të kaluarën tuaj.

Në të vërtetë, prej Eukaristisë na vjen forca për të kapërcyer dobësitë e brendshme dhe kundërshtitë e jashtme që Shën Pali i ka ndeshur në ushtrimin e shërbesës së tij apostolike, siç na ka kujtuar në leximin e dytë.

I takojmë ato, në fakt, edhe ne në misionin që Zoti ua ka besuar pa dallim të gjithë të krishterëve me Pagëzimin: atë që të shpallim e të dëshmojmë shkëlqimin e lavdishëm të Ungjillit të Krishtit, kudo dhe gjithmonë, në shtëpi, në rrugë, në vendin e punës, në shkollë dhe në fushën politike; pa frikë, pa turp, pa u shkurajuar, me gëzim, me guxim, me entuziazëm, të bindur sikurse Sh. Pali, se jemi gjithmonë të ndihmuar prej fuqisë së jashtëzakonshme të Hyjit prandaj mund të jemi të munduar por jo të shtypur, të tronditur por jo të dëshpëruar, të përndjekur por jo të braktisur, të goditur por jo të vrarë, ashtu si shumë të

HOMELIA E KARDINALIT SALVATORE DE GIORGI

◀ *Vijim i fq. 4*

mbijetuar në mesin tuaj. Për të qenë në gjendje të shpallim Ungjillin duhet ta njohim atë, sepse vetëm duke njohur Ungjillin njohim Jezusin. E si? Nëpërmjet leximit të tij të përditshëm, sikurse nuk lodhet duke porositur Papa Françesku. Besoj se të gjithë në shtëpi keni Biblën apo të paktën katër librat e Ungjillit. Nëse nuk i keni, kërkojani famullitarëve tuaj. Gjenerali çdo ditë të paktën pesë minuta kohë për të lexuar një pjesë të tij, mundësisht në familje. Ju siguroj se me të vërtetë hyn drita e Krishtit në familjet tuaja dhe në zemrat tuaja, duke dhuruar gëzim, harmoni, kthjelltësi e paqe.

Pastaj, për ta shpallur në mënyrë të besueshme Ungjillin duhet të jetojmë sipas Ungjillit, ta mishërojmë atë, ta bëjmë të shkëlqejë në jetën tonë, në sjelljet tona, në zgjedhjet tona, në mënyrë që, siç ka saktësuar Shën Pali, jeta e Jezusit të dëftohet në trupin tonë të vdekshëm.

Dëshmia supreme e Ungjillit është martirizimi, dhe Kisha juaj është skuqur prej gjakut të martirëve që kanë parapëlqyer të humbin jetën tokësore për të mos humbur atë të qiellit.

Ata besonin fort në jetën e pasosur, në ringjalljen përfundimtare, sepse, siç dëgjuam në Ungjill, Jezusi është ringjallur, është ringjallur me të vërtetë dhe prandaj na ka dhënë garancinë se edhe ne do të ringjallemi.00

Ne sot duam ta përtërijmë pa ngurrim fenë tonë në ringjalljen dhe në jetën e pasosur, siç pohojmë në Besojmë dhe siç kemi kujtuar para pak ditësh në Përkujtimin e të vdekurve. Kjo varrezë, që do të thotë fjetore dhe në pritje të ringjalljes ruan mbetjet e vdekshme të të dashurve tuaj, sidomos të atyre të vrarë për besnikëri ndaj Ungjillit,



sikurse Shërbëtori i Hyjit Gjon Gazulli, i varur, varrin e të cilit ju e quani “varri i Shenjtit”, na kujton se vdekja nuk është fundi i jetës, por fillimi i jetës pa fund dhe Eukaristia është garancia e saj. Këtë donte të shprehte dom Simoni njëzet e pesë vjet më parë duke kremtuar në këtë vend, në

qiell të hapur e publikisht Meshën e Shenjtë, duke sfiduar ndalesat dhe zemërimin e përndjekësve e duke rizgjuar guximin e të ndrojturve për të marrë pjesë me fenë e martirëve, s i d o m o s t ë 3 8 Shërbëtorëve të Hyjit, për të cilët presim me besim lumturimin.

Këtë pret prej jush Jezusi me Nënë e vet Marinë! Në këtë ju nxit Arqipeshkvi juaj. Këtë jua porosit nëpërmjet zërit tim Papa Françesku, që me rastin e vizitës së vitit të kaluar ju drejtoi fjalë që jehojnë gjithmonë aktuale

për ecjen tuaj të fesë: “Shkoj shpirtërisht te ai mur i varrezës së Shkodrës, vend-simbol i martirizimit të katolikëve ku kryheshin pushkatimet, dhe me ngashërim vendos lulen e lutjes dhe të kujtimit mirënjohës e të përhershëm.

Zoti ka qenë pranë jush, shumë të dashur vëllezër e motra, për t'u përkrahur; Ai ju ka drejtuar e ngushëlluar dhe së fundi ju ka ngritur mbi krahët e shqiponjës sikurse një ditë bëri me popullin e lashtë të Izraelit, siç dëgjuam në leximin e parë. Shqiponja, e paraqitur në flamurin e Vendit tuaj, ju thirrte në ndjenjën e shpresës, që ta vendosni gjithmonë besimin tuaj në Hyjin, që nuk zhgënjën por është gjithmonë pranë nesh, sidomos në momentet e vështira”. Dhe ky është edhe urimi im që, me dashuri dhe admirim, e vë në altarin e flisë eukaristike.

BEKIMI PAPHOR

Vëllezër e motra të dashura,
Në përfundim të këtij kremtimi Eukaristik solem, do të marrim bekimin papnor, që duke nxjerrë nga pasuria e bashkimit me shenjtërit e Krishtit shpëtimtar, do të na ndajë ndjesën e plotë me faljen e çdo pengu të duhur për mëkatet. Të rrëfejme atëherë fajet tona dhe të përvujtërohemi nën dorën e fort të Zotit, që të na ngazëllesh në orën kur do të na vizitojë.

Në përfundim të punës së pendimit të përdorët formula që pason:
*Për meritat dhe për ndërmjetësinë
e së lumes gjithmonë Virgjërës Mari,
të shenjtërve Apostujve Pjetrit e Palit e të të gjithë Shenjtërve,
Hyji i gjithpushtetshëm dhe i mëshirshëm
ju dhashtë një kohë të përshtatshme
për një pendim të sinqertë dhe të frytshëm,
për kthimin e vazhdueshëm të zemrës
dhe përtëritjen e jetës,*

*qëndrushmërinë në veprat e mira,
ju faltë mëkatet tuaja
dhe ju përcjelltë në jetën e pasosur: R. Amen.*

Në përfundim të lutjes pas kungimit, diakoni shpall bekimin me këto fjalë.

*Ati ynë i nderuar Salvatore De Giorgi,
prej hirit të Hyjit dhe nga përcaktimi i Selisë Apostolike
Kardinal i Kishës së Shenjtë të Romës me titull Shën Maria në Aracoeli
Në emër të Papës së Romës
do të japë bekimin me ndjesën e plotë
të gjithë besimtarëve që të nxitur nga pendimi i sinqertë,
janë rrëfyer e kunguar, dhe kanë marrë pjesë në këtë kremtim.
Luteni Hyjin për fort Shenjtërinë e Tij Papën tonë Françeskun
për Kardinal Salvatore, për Arqipeshkvin tonë Angelo
për të shenjtën Nënë Kishë
dhe mundohuni që të jetoni shenjtërisht*

NDËRHYRJA E KRYEMINISTRIT TË SHQIPËRISË Z. EDI RAMA



Rasti e deshi që unë të vij këtu, sot, si Kryeministër. Por do të isha këtu, sot, edhe nëse nuk do të isha Kryeministër.

Si njëri prej atyre 300 vetëve që në 4 nëntor të 25 viteve më parë kam qenë këtu. Kam qenë këtu, bashkë me disa miq. Jemi nisur shumë herët me tren nga Tirana, pasi na kishte mbërritur fjala që Dom Simoni i madh do të bënte një meshë. Dhe nëse nuk do të kisha qenë këtu, bashkë me 300 vetë të tjerë që janë dëshmitarë të asaj dite, nuk do të kisha pasur kurajën që të kujtoja një moment të asaj meshe, sepse me siguri do të më merrnin për të marrë.

Kujtoj se atë ditë ka qenë një kohë shumë e vrenjtur, krejtësisht e mbuluar kjo varrezë nga retë, rrethuar matanë rrugës së hyrjes nga njerëz të sigurimit dhe policisë së asaj kohe dhe pikërisht gjatë fjalës së Dom Simonit është hapur qielli dhe një rreze drite ka rënë mbi këto varreza.

Ka qenë një moment i paharrueshëm dhe rrezja e dritës që çau qiellin për të shoqëruar fjalën e Don Simonit ka qenë momenti i parë, besoj unë, për të gjithë ata që ishin këtu, i çlirimit nga ankthi dhe i një përjetimi të jashtëzakonshëm të së vërtetës se e shkuara ishte tretur në të shkuar dhe se e ardhmja sapo kishte filluar të merrte frymë, këtu, në këtë tokë të bekuar të këtyre varrezave.

“Do të ngjitem drejt altarit tënd Zot, të Zotit që lumnon rininë time.”

Të dashur miq, këto janë fjalët që çelin në latinishten e katakombeve, Psalmin 42, mjeshtërisht të përkthyer nga hebraishtja prej Shën Jeronimit nga Iliria, në shekullin e 4-t dhe janë fjalët e para liturgjike që belbëzoi i paharruari Dom Simon Jubani, tek nisi të belbëzonte në një altar të improvizuar, por me një solemnitet të pakrahasueshëm me asnjë nga meshët solemne, meshën e parë në Shqipërinë, ku atë ditë këtu, rilindi Zoti.

25 vjet na ndajnë me atë ditë, pothuajse po aq sa ditë e ndanin nga viti i mbrapshtë 1967, gjatë të cilit, kujton At Zef Pllumi, meshtarët fshihnin nën altare, jo armët që trumbetonin nga propaganda e errësirës, por paramentet dhe enët e shenjta të kultit, për t'i ruajtur nga përdhosja e barbarisë.

Me ato paramente të mrekullueshëm, që të kujtojnë portretet mbresëlënëse të Shën Injacit të Lojolës, apo të Shën Philip Nerit, të veshur me pavdekësinë e piktorëve më të mëdhenj të Rilindjes, u shfaq në 4 nëntor të vitit 1990, këtu, në këto varreza, figura e Dom Simon Jubanit.

Me të dhe së bashku me një popull të dendur dhe të mbledhur grusht njeri pas tjetrit, si për të përballuar ankthin e momentit të parë, por të bashkuar në etjen për lirinë e ndërgjegjes, u rishfaq dhe forca e shembullit si ngadhënjim mbi shembullin e forcës, e cila për 45 vjet iu

imponua këtij populli si i vetmi besim për t'u adhuruar.

Brenda këtyre mureve ndodhi një nga ato dukuri të rralla shpirtërore dhe morale, të cilat ne shqiptarët, për fatin tonë të mirë apo të keq, dukemi të destinuar t'i përjetojmë në forma jo të zakonshme dhe po ashtu, duke përjetuar në kohë në dukje të zakonshme, të përjetojmë ndjesira që i kanë përjetuar njerëzit shumë e shumë kohë më parë.

Sikundër gjatë meshës së shenjtë ripërtërihet në altar sakrifica përtej kohe e Krishtit mbi Kryq, atë që vetë Niçja e cilësonte si imazhin më sublim të njerëzimit, po ashtu si jashtë çdo parametri kohor u ripërtërit duke filluar nga këtu, në të gjithë Shqipërinë, një histori martirizimi unike, jo vetëm e një kishe por e gjithë një besimi dhe jo e një besimi të vetëm, por një vetëdije bashkëjetese rreth misterit të jetës dhe intimitetit të ndërgjegjes.

Sikundër krishtërimi në totalitarizmin perandorak, lindi në Europë, në katakombe, duke lëvruar farën e emancipimit dhe të lirisë së ndërgjegjes, po ashtu në këto varreza në këtë tempull, nën qiellin e hapur të Rrmajit, kisha nëpërmjet fjalës dhe liturgjisë, pedagogje të shpirtit u bë tharmi i emancipimit të një populli të tërë drejt lirisë dhe vetëvendosjes që pasoi në kohët pas meshës së 4 nëntorit.

Historia mund të shkruhet gjithsesi dhe sidoqoftë mbi historinë ata, të cilët e jetojnë kanë këndvështrime të ndryshme. Por unë hyj tek ata, që besoj se historia e ndryshimit të madh në Shqipëri, filloi atë ditë, këtu, dhe se pararendësi i parë i saj ishte Dom Simon Jubani.

Në imazhe dhe në simbole që janë ekonomia e fjalëve të pathëna dhe të pashqiptueshme, për nga forca që mbartin, çfarë ndodhi në fund të vitit '90 në nëntor këtu, nuk mund të ndodhte askund tjetër përveçse këtu. Ky vend nuk është i paqte dhe i amëshuar sepse është një varrezë. Ky vend është shumë më tepër sesa një varrezë. Ky vend është një kopsht shpirtëror dhe një lëndinë jo për vaje, por për lutje në paqe dhe me shpresë.

Kapela, më në fund lumturisht e restauruar, falë përkushtimit në radhë të parë të Dioqezës së Shkodrës, punës së admirueshme të famullitarit Dom Artur Jakut, besnikërisë së diasporës shqiptare në Amerikë, ku edhe ne patëm nderin e madh t'i japim një dorë, mban në kornizën e arkitraut të saj, fillimin e lutjes së përbotshme të rekuemit: “Jepjau Zot, pushimin e pasosun”.

Me stilin e saj palladian e neoklasik, me kubënë diskrete dhe kolonat e hijshme toskane, kapela, e konceptuar nga një tjetër shkodran, Ludovik Zojzi, dishepull i At Gjergj Fishtës, përvizohet nga një harmoni dhe gjeometri estetike që i jep Rrmajit trajtat unike dhe për hir të vërtetës, në gjithë tërësinë e pasurisë së paluajtshme të kishës sonë nuk e ka një të dytë në Shqipëri, nuk ngjan me asgjë tjetër.

Çdo monument këtu në fushën e varrezave është më shumë sesa varri i dikujt, është si një stacion në historinë e kishës, në historinë e kulturës, në historinë e arteve dhe në historinë shpirtërore të Shkodrës, që është padyshim jo pjesë, por një pjesë pa të cilën historia e Shqipërisë do të humbte kuptimin. Qoftë varri i njerëzve me famë si Kol Idromeni, Hil Mosi, si Pjetër Marubi e Preng Jakova, qoftë ai i familjeve të fisme shkodrane të Sumajve, Shirokajve, Jubanëve dhe deri tek varret e personave të panjohur, kanë të gjitha së bashku një emërues, që është ai i kësaj lëndine shpirtërore, bëhen shoqi-shoq të barabartë në dinjitet me princër të kishës si ipeshkvi Karl Poten, Lazër Mjeda dhe Gaspër Thaçi.

I ndjeri dhe i paharruari Kol Kasmi, pinjolli i një prej familjeve më të shquar patrice të Shkodrës, brez pas brezi djep pas djepi klerikësh, prelatësh, diplomatësh, me zgjuarsin të pashoqe e mbledhi në këtë gjeometri kulture, një justifikim që është historik, që ia vendosi në tavolinë Enver Hoxhës, duke arritur ta ruajë të paprekur arkitekturën mbresëlënëse dhe çdo cep të kësaj varrezë. Duke e ruajtur gati si monument kulture varrezën e Rrmajit, ai bëri që diktatura, e verbuar në tërbimin e vet kundër fesë, kundër besimit e besimtarëve, të bëhej padashje dhe pa e kuptuar mbrojtësja e kësaj pasurie, duke lënë pas dëshminë më therëse të barbarisë së saj.

Parafytyroni, nëse në atë orgji të pashembullt zjarri e hekuri, gjaku e flakësh, ku u hodhën në erë me dinamit 2000 e disa qindra kisha e kapela romane në Shqipëri, ku u dogjën rrugëve mbi 300 mijë libra fetarë dhe vepra të artit fetar, të ishte fshirë edhe ky truall, të ishte bërë rrafsh. Një rrafsh mbi të cilin, ajo çka e bëri legjendare meshën e 4 nëntorit do të ishte e pamundur.

Ne jemi shumë me fat që sot jemi këtu dhe në rrugëtimin për të hyrë në

NDËRHJRJA E MINISTRES SË KULTURËS
ZJ. MIRELA KUMBARO

“Dalëngadalë turma drejt alterit u shtua. Mesha e parë në madhëstsinë e vet mbeti një fakt i izoluar, por shërbeu si fillim i atij organizimi që një javë më pas solli 11 nëntorin, meshën solemne të rikthimit të besimit”, rrëfente Dom Simon Jubani Dëshmitarë të asaj dite kujtojnë se 4 nëntori ishte një ditë me shi dhe disi e ftohtë. Kam qenë në ato ditë nëntori të vitit 1990 në Shkodër dhe e kujtoj grinë e ftohtë të këtij qytetit, ku në teatrin Migjeni dhe rreth kësaj kapele po ndizeshin zjarret e para të lirisë pas një diktature të egër.

Më të egrës. Shkodra ishte qyteti që diktaturën e luftoi me humor, me art dhe me besimin te Zoti. Nga data 5 e deri në orët e para të datës 11 nëntor, varrezat katolike të Rrmajit u kthyen atëherë në një shesh ndërtimi. Të gjithë, pa dallim feje dhe moshe, me sa mundnin, punonin me forcën e shpirtit për të krijuar vendin e përshtatshëm për meshën që do mbahej për të gjithë. Në 4 nëntor të vitit 1990 u hodh hapi i parë drejt lirisë së mendjes, ku Dom Simon Jubani mbledhi disa qindra vetë, një javë më pas Fjala u çlirua nga mendja e doli në shesh. Në atë ditë kurrkush nuk ndihej mysliman, katolik apo ortodoks, fantazmat e arratinë dhe të gjithë e ndjenin veten bij të të



njëtit Zot. – kujtonte Dom Simon Jubani.

Fjala që ishte e para, mbledhi ne meshën e pare të plotë disa dhjetra mijëra duke treguar se sa të uritur ishim për Liri e Demokraci. Kremtojmë sot meshën e parë të lirisë. Sot kremtojmë, por edhe kujtojmë. Kujtojmë që të mos harrojmë. Të mos harrojmë martirët jo vetëm të Kishës, por edhe të Lirisë së mendimit e të besimit, që u ekzekutuan dhunshëm aty te Çinari i Zef Zorbës. Jo vetëm kaq. Në këto varre ka dhe histori të kulturës jo vetëm shkodrane por mbarëkombëtare! Sot, 25 vjet më pas, nën kujdesin e Kryeministrit, Ministria e Kulturës dhe Insituti i Monumenteve të Kulturës, punoi me profesionalizëm e dashuri dhe në bashkëpunim të ngushtë me Dom Arturin e Dom Nikën, për restaurimin e Kapelës, dhe të varrezave tashmë Pasuri kulturore, dhe Vlerë historike!

Ta gëzoni ju, besimtarë të Kishës katolike, por ta gëzojmë dhe ne të gjithë bashkë me ju, sepse mrekullia ndodh pasi edhe sot kurrkush nuk ndihet mysliman, katolik apo ortodoks, fantazmat e përçamjes kanë marrë

arratinë dhe të gjithë e ndjejmë veten bij të të njëtit Zot.

NDËRHJRJA E KRYEMINISTRIT TË SHQIPËRISË
Z. EDI RAMA

◀ Vijim i fq. 6

këtë shesh, janë aty të gjithë ata, të cilët janë në rrugën e lumturimit dhe të shenjtërimit dhe që për shkak të asaj barbarie e kanë vendosur Shqipërinë, këtë vend kaq të vogël, në krye të listës së të gjithë vendeve të botës së krishterë për numrin e martirëve. Dhe kur? Në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar!

Më lejoni që t’ju them se ne do të vazhdojmë të bëjmë gjithçka kemi në dorë, me mundësitë modeste, për të ndihmuar komunitetet e besimeve, që t’i rifitojnë qoftë në hijeshi, siç ka rifituar ky komunitet këtë kapelë, qoftë edhe në fakt të gjitha pasuritë që kemi trashëguar.

Ky nuk është një promovim për kultet, nuk është një financim publik i një kulti. Këtu bëhet fjalë për diçka që e thotë në mënyrën më të shkëlqyer, një tribunë e publikuar në gazetën londineze The Times, në 6 korrik 1971, katër vjet pas ndalimit të fesë në Shqipëri dhe që mban firmën e emrave më të shquar të artit e të letrave të asaj kohe, shumë pak nga të cilët ishin katolikë; Vladimir Ashkenazy, Agatha Christie, Yehudi Menuhin, Robert Graves, Jorge Luis Borges, Cristina Campos, Giorgio De Chirico, Carl Theodore Dreyer, Benjamin Britten, Kenneth Clark, Lord



Acton. Dhe dua ta citoj se çfarë shkruajnë në reagim të saj që ndodhi edhe këtu dhe që vinte në mbrojtje të asaj meshe që celebroi në latinisht Dom Simon Jubani, në vijimësi të pandërprerë me meshën e celebruar shekuj më parë prej Pal Ëngjëllit dhe Ndre Mjedës më pas, Marin

Barletit dhe Gjergj Fishtës në kohë të ndryshme, Shtjefën Gjeçovit dhe Vinçens Prenushit, Pjetër Bogdanit e Luigj Bumçit. Ja çfarë thotë:

“Mesha katolike nuk ka frymëzuar vetëm mistikët, por edhe poetët, filozofët, muzikantët, arkitektët, piktorët dhe skulptorët në çdo vend e në çdo epokë. Prandaj ky rit i përket jo vetëm klerikëve katolikë dhe besimtarëve, por gjithë kulturës së përbotsme në civilizimin materialist dhe teknokratik në të cilin jetojmë, që i kanoset përditë e më shumë inteligjencës dhe jetës së shpirtit në shprehjen e saj krijuese më fillestare, fjala dhe veprat, do të ishte

çnjerëzore të privohej njeriu nga kjo formë shprehjeje, pra, nga riti katolik që është një nga shfaqjet më madhështorë të natyrës poetike të vetë njeriut.”

4 Nentor 2015

Në orën 17.00 u mbajt një koncert me pjesëmarrjen e koreve të ndryshme, organizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës.

Me këtë koncert u mbyllën të gjitha aktivitetet mujore, me rastin e 25 vjetorit të Meshës së Parë, në të cilin morën pjesë, për here të parë, të gjitha koret dhe orkestrat e qytetit tonë. Me këtë rast Arqipeshkvi, Imzot Massafra, i përshëndeti dhe i falenderoi të pranishmit, dom Artur Jakun, Administrator Famullitar, me bashkëpunëtorë, për realizimin me sukses

të këtij përvjetori. Po ashtu Ai falenderoi Ministrinë e Kulturës për bashkëpunimin, si dhe koret e qytetit që të vazhdojnë në këtë frymë bashkëpunimi.

Në emër të kësaj Ministrie përshëndeti zv/Ministri, z. Zef Çuni. Mbrëmja u mbyll me këngën Zojës së Shkodrës: “T’falëm Mari”.



DEKLARATË E IPESHKËVIJVE MBI EMIGRACIONIN DHE REFORMËN NË DREJTËSI

Ndër temat e diskutuara gjatë Asamblesë së Zakonshme të Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë në datat 10 dhe 11 nëntor 2015, dy prej tyre kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën, jo vetëm të besimtarëve katolikë, por të gjithë shoqërisë shqiptare.

Së pari tema e ndjeshme e emigracionit për arsye ekonomike e një numri të madh shqiptarësh. Sipas agjencive të ndryshme ka një numër të madh aplikuesish të cilët kërkojnë të ikin në vende të tjera për të jetuar e punuar, së bashku me familjet e tyre. Ne mendojmë se kjo është për shkak të situatës ekonomike të vështirë që shumë familje shqiptare kalojnë dhe rritja e papunësisë për moshën e re. Nëse nga njëra anë ne bëjmë thirrje që shqiptarët të mos e braktisin vendin e tyre, por të gjejnë motive për të qëndruar e jetuar këtu, nga ana tjetër shikojmë te faktori shtetëror dhe ai politik përgjegjës për këtë ikje të shqiptarëve e sidomos të rinjve.

Tema e dytë është ajo e reformës në drejtësi që këto ditë po debatohet shumë. Ideja e një reforme sipas këndvështrimit tonë është domosdoshme. Ne si ipeshkvij të Kishës Katolike, edhe në

emër të besimtarëve katolikë, e mbështesim dhe e inkurajojmë këtë reformë, sidomos nëse ajo ka për qëllim të godasë korrupsionin në sistemin e drejtësisë i cili është një e keqe shumë dëmshme për shoqërinë tonë.

Ne nga ana jonë në bashkësitë tona përherë bëjmë thirrje për respektimin e ligjeve që garantojnë një bashkëjetesë më të mire dhe një shoqëri më të mirë. Dhe apelojmë të gjithë që të kontribuojnë në këtë drejtim qoftë faktorin politik, partitë politike, parlamentin, punonjësit e drejtësisë etj.

Në mënyrë të veçantë ne u bëjmë thirrje e u kujtojmë juristëve katolikë që punojnë në sistemin e drejtësisë, gjyqtarë, prokurorë apo avokatë, që të jenë shembull në ushtrimin e drejtësisë. Besimi në Zotin nuk përputhet me korrupsionin dhe ryshfetin të cilat përveçse janë një shkelje e ligjit, janë edhe një mëkat që lyp llogari përpara Zotit dhe Kishës.

*Zyra e Shtypit
e Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë*

MESAZHI I PRESIDENCËS SË KONFERENCAVE IPESHKVNORE TË EUROPËS MBI SULMET TERRORISTE NË PARIS

Shkëlqesisë së tij Imzot Georges Pontier,
Arqipeshkëv i Marsejës dhe President i Konferencës Ipeshkvore të Francës
Zotit Kardinal André Vingt-Trois,
Arqipeshkëv i Parisit

Llahtari i sulmeve terroriste në Paris dhe në Stadiumin e Francës, mbrëmjen e datës 13 nëntor, që kanë shkaktuar shumë viktima dhe plagosur shumë të tjerë, kanë zhytur në zi krejt njerëzimin. Presidenca e Këshillit të Konferencave Ipeshkvore të Evropës dhe sekretariati i tij bashkohen në lutje për vuajtjen e familjeve të viktimave, me dhimbjen e popullit francez dhe me britmën e atyre që kërkojnë të jetojnë dhe të ndërtojnë paqen. Po e përsërisim: askush në botë nuk mund t'i justifikojë

këto akte të dhunshme, mizore dhe të shëmtuara.

Do të lutemi për të gjithë ata që në këto sulme kanë humbur jetën që të pushojnë pranë Atit të mëshirshëm dhe që, në këtë provë, i Gjithëpushtetshmi të ngjallë tek të gjithë ndjenja paqeje dhe solidariteti, sidomos te këto bashkësi.

Kardinal Péter Erdő,
President i Konferencave Ipeshkvore të Evropës
Kardinal Angelo Bagnasco,
Zëvendës-President i Konferencave Ipeshkvore të Evropës
Shkëlqesia e Tij Imzot Angelo Massafra,
Zëvendës-President i Konferencave Ipeshkvore

San Gallo Zvicërr, 14 nëntor 2015

“PROJEKTI SHPRESA” KREMTON 20 VJETORIN E THEMELIMIT

Më 24 tetor 2015, në teatrin “Migjeni”, “Projekti Shpresa” mbledhi së bashku, dashamirës, kontribues, drejtues, punonjës, të rinj e të reja të kësaj Shoqate dhe jo vetëm, për të festuar “20 vjetorin” e themelimit të saj. Ishte tejet emocionuese të përkujtohej se pikërisht 20 vite më parë, në tetor të vitit 1995, ka filluar një mision historik dhe human në përkushtim të personave me aftësi të kufizuara, nga një asistente sociale, vullnetare, Dr. Silvana Vignali, e cila të gjithë jetën e saj e kishte kaluar në shërbim të tjerëve, veçanërisht të atyre që kanë patur më shumë nevojë në Itali. Në vitin 1994 ajo erdhi në Shqipëri për t’iu përkushtuar një kategorie të parajshuar dhe thajse të përjashtuar nga shoqëria, personave me aftësi të kufizuara. Kështu, asaj i ka mjaftuar një vizitë në institucionet psikiatrike dhe jetimoret shtetërore për të kuptuar se sa e nevojshme ishte t’i përvishesh punës në shërbim të këtyre personave, për të ofruar një model ndryshe në trajtimin e tyre, duke krijuar kështu modelin e Shtëpisë – Familje, një ambient ku gjejnë përgjigje problemet e tyre. Ku ata ndjehen të dashur e të vlerësuar.

Çdo ditë e jetës së saj, që nga viti 1994 deri në ditën e ndarjes nga jeta (14 shkurt 2012), qe e mbushur me shërbim dhe punë të palodhur, me përkushtim e dashuri, me sakrificim e këmbëngulje, me qëllim që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre si çdo qytetar tjetër. Ajo me punën dhe jetën e saj tregoi se veprat japin fryt atëherë kur veprojmë me dashuri.

Projekti Shpresa nëpërmjet aktivitetit të titulluar “20 vjet shërbim, dashuri dhe shpresë” jo vetëm ka përkujtuar por ka njohur progresin që është bërë. Ky 20 vjetor përfaqëson një udhëtim, pasi pa dyshim konsiston në një shërbim human, të palodhur dhe të pashtershëm.

Aktiviteti u hap me dokumentarin “Një zë i heshtur shprese” i përgatitur me mjeshtëri nga Valmir Hysa, Ergys Kavaja dhe Klodjan Bregu, në të cilin u paraqitën fakte historike që me krijimin e shtëpisë së parë familje e deri në ditët e sotme. U paraqitën dëshmi nga të rinj e të reja me aftësi të kufizuara që jetojnë në Shtëpitë - Familje dhe nga kujdestarë social të cilët u shprehën për ndryshimin pozitiv të jetës së të rinjve.

Pas hapjes së aktivitetit nga psikologjia klinike e Shoqatës znj. Suela Ndoja dhe punonjësi i Qendrës Ditore z. Tomas Delia, fjala iu dha z. Luigj Mila, Presidentit të Shoqatës “Projekti Shpresa” i cili falenderoi të pranishmit, bashkëpunëtorët dhe kontribuesit që kanë ndihmuar për ta çuar përpara misionin dhe objektivat lidhur me përkujdesjen sociale të personave të cilët janë të braktisur dhe jo vetëm kaq. Z. Mila ia dha fjalën Arqipeshkvit Shkodër-Pult Imzot Angjelo Massafra i cili përshëndeti përzemërsisht dhe mbi të gjitha vlerësoi punën e palodhur që është bërë dhe vazhdon të bëhet nga i gjithë stafi i “Projekti Shpresa”, përfshirë kujdestarë social, duke tërhequr edhe vëmendjen e instancave më të larta për ecurinë e mëtejshme. Me këtë rast Atij iu akordua një certifikatë mirënjohjeje “Për mbështetjen dhe kontributin që Imzot Massafra ka dhënë, që nga themelimi i Shoqatës”. Më pas në skenë për të përshëndetur u ngjit kryetarja e Bashkisë Shkodër znj. Voltana Ademi

e cila e cila në fjalën e saj premtoi mbështetje të mëtejshme për banorët e “Projektit Shpresa”.

Shërbimi ndaj personave me aftësi të kufizuara përbën një mision të bekuar dhe për të realizuar këtë mision human, kanë kontribuar dhe vazhdojnë të kontribuojnë shumë persona saqë na bën të ngjasojmë me një forum të hapur për këdo që është i interesuar dhe tregon dashamirësi në realizimin e tij. Ndër të tjerë mund të përmendëm:

Comittato della lotta contro la fame nel mondo, Progettiamo la Speranza, Gruppo India, Caritas di Madrid, Soidarieta senza Confini, Fondazione Entreculturas, Missione San Lorenzo, Diocezi di Grosseto, Caritas Terra del Sole, Cafod, San Giovanni Batista di Campagnatico, Bashkia Shkoder, Caritas Shqiptar, Caritas Shkoder e shumë e shumë famulli, shoqata dhe individë qoftë nga Italia, Spanja apo Shqipëria etj.

Ndër ta na nderoi praninë e tij Paolo Trubiano, President i Shoqatës “Progettiamo la Speranza” (Projektojmë Shpresën) i cili po ashtu u nderua me një certifikatë mirënjohje. Në vijim fjala iu dha Drejtoreshës së Shërbimeve Sociale, znj. Valbona Tula, nga sektori i shëndetit mendor, një përfaqësuesi të mjekjes psikiatre Dr. Valdet Hoxha, nga sektori i shëndetit të përgjithshëm dhe mjekes së familjes. Dr. Vilarta Thaçi. Në sallë përveç të rinjve e të rejave të shtëpive-familje të Projektit

Shpresa të shoqëruar nga kujdestarë social dhe stafi organizativ ishin të pranishëm edhe përfaqësues të Zyrës së Çështjeve Sociale, Bashkia Shkoder, Zj. Rudina Kruja, Zj. Jeta Xhabija, nga Qendra e Zhvillimit Shtetëror, ish drejtore Zj. Marije Koliqi dhe logopedja Zj. Linda Duro, nga Shoqata “Madonnina del Grappa”, Koordinatori. Fabrizio Nocchi së bashku me stafin profesional, kujdestarë e të rinjtë e të reja me aftësi të kufizuara që jetojnë në kësaj Shoqate, nga

Instituti i Motrave të Nënë Terezës, përfaqësues, kujdestarë social dhe vajzat e këtij Instituti dhe përgjegjësjë e aktiviteteve Zj. Ardiana Marku, nga Instituti i Motrave Stigmatine dhe përfaqësues të famullive dhe OJQ-ve të ndryshme dhe individë nga Shkodra dhe Tirana. Aktiviteti socio-artistik ishte i larmishëm, me këngë, valle dhe performanca nga të rinjtë e “Projektit Shpresa” por jo vetëm. Psikologjia klinike. Në mbyllje përsëri mori fjalën Presidenti i Projektit Shpresa i cili ndër të tjera falenderoi organizatorët e aktivitetit Zj. Suela Ndoja dhe Z. Tomas Vata për përkushtimin dhe punën e tyre si dhe gjithë kontribuesit dhe mbështetësit e “Projektit Shpresa” duke uruar më të mirën dhe jetëgjatësi për projektin në mënyrë që shpresa të vazhdojë të jetë e pranishme për personat me aftësi të kufizuara. Së fundmi u shpërndanë certifikata mirënjohjeje për të gjithë kontribuesit dhe mbështetësit e përhershëm të Projektit Shpresa.

Stafi Organizativ i Shoqatës “Projekti Shpresa”

PAJTIMI ËSHTË GJITHMONË I MUNDUR



Me 14 – 15 Nëntor u zhvillua në Fshatin e Paqes në Shkodër, takimi me universitarët mbi temën "Pajtimi është gjithmonë i mundur". Të pranishëm ishin të rinj universitarë nga Shqipëria, Kosova, Italia dhe Gjermania.

Fjalimi i mbajtur nga Padre Gian Franco Testa në lidhje me temën, ishte mjaft domethënës dhe interesant për të gjithë të pranishmit, duke lënë të kuptohet se pajtimi nuk është diçka e lehtë, por nuk është as i pamundur.

Interesi që të rinjtë pjesëmarrës kishin për temën u shfaq edhe nga pyetjet që ata drejtuan në fund të fjalimit. Pyetjet e tyre lanë të kuptohet se brezi i të rinjve është i gatshëm për mirëkuptim, falje e pajtim, e si rezultat i këtyre vjen paqja që aq shumë e dëshirojmë.

Gjatë këtyre dy ditëve të rinjtë u angazhuan në diskutimet mes grupeve, ku secili kishte mundësi të

shprehte opinionet dhe qëndrimet e tij lidhur me temën si dhe në workshopet e përgatitura. Qëllimi kryesor ishte përfshirja e të gjithëve dhe pikërisht këto diskutime në grupe dhe puna në workshope tregoi edhe rezultatin e këtij takimi. Të gjithë pjesëmarrësit shprehën mendimet e tyre mbi temën në mënyra nga më të ndryshmet ku mund të përmenden: shkrimi, fotografia, piktura, teatri, mozaiku.

Një moment i shejtë ishte Mesha e mbajtur nga Imzot Angelo Massafra. Të gjithë të bashkuar duke u lutur për sa më shumë pajtime e paqe. Në fund të takimit të gjithëve iu shpërnda fleta me gjeten e ullirit, simbolit të paqes, që mbante mbishkrimin: "May peace prevail on Earth" (Le të mbizotërojë paqja mbi Tokë).

Vërtet, sa shumë ka nevojë bota për pajtim, sa shumë ka nevojë bota për paqe! Për të arritur këtë duhet të falim sa më shumë DASHURI!

Motër Rita Ndoci



VITI JUBILAR I MËSHIRËS NË SHKODËR-PULT

Të nderuar Meshtarë, Rregulltarë dhe Rregulltare
Të dashur besimtarë.

Po afrohet me të shpejtë përvoja e Vitit Jubilar të Mëshirës. Duam të përgatitemi për ta marrë këtë dhuratë të hirit të një kohë të volitshme në të cilën edhe një herë do të përjetojmë fytyrën e mëshirshme të Hyjit dhe përqaftimin e tij atëror.

Për Kishën tonë të Shkodër-Pultit kjo përvojë fillon pas kremtimeve të 25-vjetorit të Meshës së parë në varrezat e Shkodrës.

Hapja e Vitit të Shenjtë të Mëshirës do të jetë në Romë më 8 dhjetor, në të kremten e Zojsë së Papërlyer, ndërsa për dioqezën tonë është caktuar për të dielën më 13 dhjetor, në orën 15.00. Do të takohemi në orën 15.00 pranë kuvendit të shën Françeskut në Gjuhadol për të nisur ecjen pendestare deri në Kishën tonë Katedrale, ku do të hapim Derën e shenjtë. Më 19 dhjetor do të jetë hapja e Derës së shenjtë në Shenjtëroren e Zojës së Këshillit të Mirë.

Sipas porosive të Papa Françeskut mund të ushtrojmë veprat e bamirësisë trupore dhe shpirtërore në shtëpitë familjeje, te Motrat e Nënë Tereze dhe me semurët e pleqët.

Gjithashtu, ju jap disa udhëzime për të realizuar një ecje të vërtetë jubilarë:

- Të përjetohet mëshira nëpërmjet Sakramentit të Pajtimit, duke kushtuar në të gjitha famullitë, të Premten, një kohë të përshtatshme për t'u dhënë besimtarëve mundësinë të kremtojnë pendesën.

- Të vlerësohet nisma e 24 ORËVE PËR ZOTIN (gjatë krezhmeve), e dëshiruar nga Papa Françesku, të paktën në nivel dekanal.

- Të propozohet dëgjimi i Fjalës në kohët e forta të vitit mbi temën e mëshirës. Të vlerësohet ungjilli i Lukës dhe disa pjesë të Besëlidhjes së Vjetër.

- Në çdo famulli një herë në tre muaj të kremtohet dita e Caritas-it famullitar për të ndihmuar besimtarët të jetojnë mëshirën nëpërmjet veprave të bamirësisë materiale dhe shpirtërore.

- Një angazhim më të veçantë për të pajtuar familjet që janë në ngatërresat e në gjak

- Shtegtime zonale dhe famullitare për në Katedralen dhe Shenjtëroren.

- Vikari i Përgjithshëm bashkë me Vikarët Zonalë të organizojnë turne rrëfimi në katedralen dhe në Shenjtëroren.

- Ju kujtoj se me 27 dhjetor 2015 do të kremtojmë Jubileun e Familjeve në katedrale (Dom Raffaele do t'ju njoftoj ...)

Me urimin që të ndihmohemi më mirë për ta jetuar fenë tonë dhe për t'u ndier të përtërirë në ecjen tonë, ju përshëndes me përzemërsi.

Shkodër, 14/11/2015

+ Angelo Massafra OFM
Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër-Pult

LAJME NGA DIOQEZA E SAPËS

KUSHTIMI I PËRJETSHËM I MOTËR JUDITA BALA - KARMEL



Bashkë me festën e Shën Terezës së Jezusit Fëmijë, (01.10.2015), familja tereziane e së Lumes Virgjër Mari në Nënshat, të njohura si motrat karmelitane, gëzuan edhe në kremtimin e kushteve të përjetshme të motër Judita (Nevila) Bala.

Për të falenderuar Zotin dhe për të bashkëndarë gëzimin e kësaj dite, ishin të shumtë besimtarët e famullisë së Nënshatit dhe fshatrave përreth që u mbledhën në kishën e Motrave pranë kuvendit karmelitan për të marrë pjesë në Kremtimin Eukaristik të udhëhequr nga Ipeshkvi i vendit Imzot Lucjan Avgustini në bashkëkremtim me Atin Provincial Gabriele Morra dhe me rreth 30 meshtarë të tjerë. Por nuk munguan edhe familjarët, miqtë dhe besimtarët e famullisë së Gurit të Zi, vendlindjes së motër Juditës, kryesisht grupi i Ecjes Neokatekumenale dhe famullitari i tyre, ku pjesë e këtij grupi ka qenë dhe vetë Motër Judita para se të hynte në kuvend.

Shoqëruar me lutjet dhe me këngët e kënduara nga kori i bashkësisë “Tempulli i Zotit”, në një klimë festive shpirtërore, gjatë gjithë meshës



shenjte mbarë populli i pranishëm në kishë e lutën Zotin për zemrën e motër Juditës, që me qëndresë të orvatet rreth ecjes sipas Ungjillit dhe rregullave të Motrave të zbathura të së Lumes Virgjërës Mari nga mali Karmel, dhe tërë jetën e saj me hirin e Shpirtit Shenjt, bujarisht t'ia kushtojë në shërbim të popullit të Hyjit.

Ati Provincial në homelinë e rastit u ndal në jetën e familjes rregulltare të motrave karmelitane, që të thirrur nga dashuria e Hyjit janë burim lutjeje për mbarë vendin.

Edhe Imzot Lucjan Avgustini në fjalën e falenderimit të tij shprehi gëzimin për dhuratën dhe hirin me kushtet e përjetshme të motër Juditës, e cila është motra e katërt në kongregatat e ndryshme të dioqezës së Sapës, që kushtohet përjetësisht, përgjigje kjo e plotë që i jepet thirrjes së Zotit, i cili thërret kur do ai dhe si do ai, në rrethanat e ndryshme të jetës sonë.

Në prani të eprores, Motër Mirjam Glavina, Ipeshkvit dhe krejt bashkësisë, vazhdoi riti i kushtimit të përjetshëm të motër Juditës, e cila me vullnet të lirë dhe vendim të saj, u përgjigj se do të qëndrojë besnike deri në vdekje, duke ecur pas Krishtit të Fejuarit, në familjen karmelitane, dhe me ndihmën e Hyjit, të përqafojë përgjithmonë jetën e pastërtisë së përsosur, dëgjësë dhe varfërisë që e kanë zgjedhur Krishti Zot dhe Nëna e tij Virgjër.

Me pranimin e velit të shenjtë dhe rruzaren, si shenjë e kushtimit të saj që ta ruajë të panjollë besnikërinë ndaj Krishtit, dhe me dëshminë e bashkësisë së motrave për pjesëmarrje dhe bashkim në familjen Karmelitane, Motër Judita mori dhe emrin motër Maria Judita e Krishtit të Ringjallur.

Motër Judita (Nevila) Bala u lind me 10 shkurt 1987 në një familje katolike në Gur të Zi të Shkodrës. Shkollën tetëvjeçare dhe të mesmen e kreu në vendlindje, kurse studimet e larta i kreu në Universitetin e Shkodrës në fakultetin ekonomik. Duke pasë dhe një familje mjaft fetare, që në fëmijëri ishte e lidhur ngushtë me kishën. Shkonte vazhdimisht dhe kishte kontakte të herëpashershme me famullitarin dhe motrat që shërbenin në famulli. Ajo aktivizohej me grupin e të rinjëve dhe me katekizmin. Gradualisht filloi të ndjente thirrjen që Zoti i bëri për t'iu kushtuar atij. Një kundrim i thirrjes së plotë ishte dhe ecja me lëvizjen e neokatekumenëve. Dhe një ditë prej ditësh vendosi t'ua bënte të njohur familjarëve, famullitarit dhe motrave dëshirën e saj për të ndjekur Jezusin.

Me aprovimin e familjes së saj me 20 qershor të 2009 në moshën 22 vjeçare hyri në kuvendin e Motrave Karmelitane, dhe filloi postulandatin. Pas eksperiencës së bërë në këtë kuvend, ajo vendosi të hyjë përgjithmonë në Karmel. Me 15 tetor të 2010 hyri në Noviciat për dy vite, ku dhe mori veshjen rregulltare të Motrave Karmelitane. Me aprovimin e Eprores së Kuvendit të Motrave Karmelitane në Nënshat mori kushtet e para me datën 15 tetor 2012. Pas tri viteve të ripërtëritjes së kushteve u kushtua përjetësisht me datën 01 tetor 2015.

Violeta Marashi





facebook

HAPËSIRË MEDIATIKE

Regjistrohu në kanalin tone!

NgjarjetKishaKatolikeShkoderPult

Do të gjesh video të ngjarjeve
më të rëndësishme të dioqezës



Drejtues
Imzot Angelo Massafra

Redaksia
Arqipeshkvia

Lektore
Emanuela Marku Matija

Faqesja
Luigj Mila

Shtypshkronja
"Gjergj Fishta"
Lezhë